



**UNIVERSITETI AAB**  
ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR  
PRISHTINË

---

**RREGULLORE MBI TË DREJTAT DHE  
DETYRIMET E STUDENTIT DHE  
MËSIMDHËNËSIT**

Prishtinë, 2006

---

Zona Industriale Prishtinë – Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë  
tel & fax 038 247 524, 247 525  
[www.universitetiaab.com](http://www.universitetiaab.com), [info@universitetiaab.com](mailto:info@universitetiaab.com)



Në zbatim të Statutit të Universitetit AAB dhe mbështetur në të, Bordi i Universitetit miraton Rregulloren e mëposhtme.

## **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### Neni 1

Rregullorja mbi të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe mësimdhënësit e studentëve mbështetet në Statutin e Universitetit AAB.

### Neni 2

Kjo Rregullore i bashkëngjitet Statutit të Universitetit, dhe shtrin veprimtarinë e vet mbi të gjitha njësitë përbërëse dhe gjithë studentët e këtij Universiteti.

### Neni 3

Qëllimi i nxjerrjes së kësaj Rregulloreje është:

- a) të përcaktojë formën e punës mësimore, shkencore dhe artistike;
- b) të përcaktojë formën e vlerësimit të studentëve;
- c) të përcaktojë kushtet që duhet t'i plotësojë studenti për t'iu nënshtruar provimit;
- d) të përcaktojë kushtet për regjistrimin e vitit;
- e) të rregullojë çështjen e riprovimit dhe
- f) të përcaktojë rregulla të tjera që kanë të bëjnë me studentët.

### Neni 4

Në Universitet, format kryesore të punës mësimore janë: ligjëratat, mësimet speciale individuale dhe kolektive, seminarët, ushtrimet, kolokfiumet, praktika profesionale, detyrat e kursit, provimet përfundimtare.

Fakultetet, me miratimin e rektoratit dhe Zyrës për Cilësi të Programeve dhe Mësimit, mund të përcaktojnë edhe forma të tjera të punës mësimore, veçmas të verifikimit të dijeve të fituara.



### Neni 5

Leksionet si formë e punës mësimore, si rregull, janë me pjesëmarrje të detyrueshme për të paktën 75 % të orëve mësimore, përjashtuar disa lëndë specifike në disa degë ku pjesëmarrja është fakultative.

Në seminare, punë praktike, ushtrime dhe format të tjera të verifikimit të dijes, sipas përcaktimit të dekanatit, pjesëmarrja është e detyrueshme për të paktën 75 % të orëve mësimore.

### Neni 6

a) Studenti që frekuenton gjatë vitit më pak se 75 % të orëve mësimore të detyruara, shpallet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të hyjë në asnjë nga sesionet e provimeve të asaj lënde.

b) Ai, qoftë si student përsëritës në vitin përkatës, apo si mbartës i kësaj lënde në vitin pasardhës, i nënshtrohet të njëjtit rregull të përcaktuar për pjesëmarrje.

### Neni 7

a) Afate të rregullta – themelore në dispozicion të studentit janë gjithsej tri: afati i qershorit, afati i shtatorit dhe afati i janarit.

b) Me propozim të dekanatit dhe miratim të rektoratit, numri i afateve mund të shtohet edhe për dy të tjera, në atë të prillit dhe të nëntorit.

c) Studentët në afatet plotësuese të parapara në alinenë b) të këtij neni, maksimumi i provimeve që mund t'i paraqesin është tri provime.

d) Për studentët absolventë me vendim të veçantë, mund të organizohen afate të provimeve edhe për çdo muaj.

### Neni 8

a) Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej 5(pesë) deri në 10(dhjetë);

b) Nota 10 (dhjetë) dhe nota 9 (nëntë) shprehin suksesin e shkëlqyeshëm, nota 8 (tetë) shumë të mirë, nota 7 (shtatë) të mirë, nota 6



(gjashtë) të mjaftueshëm dhe shënohen në indeks dhe në ndonjë evidencë tjetër përkatëse;

c) Nota 5 (pesë) shpreh suksesin e pamjaftueshëm dhe për te mbahet evidencë e posaçme;

d) Në format e verifikimit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.

#### Neni 9

a) Studenti paraqet provimin së paku 8 ditë para fillimit të provimeve në shërbimin e studentëve, në raste të veçanta ky orar mund të ndryshohet.

b) Lista e kandidatëve që do t'i nënshtrohen provimit publikohet së paku tri ditë para mbajtjes së provimit.

c) Për studentin i cili nuk paraqitet në provim, për atë që pasi të ketë filluar provimin abstenon dhe për studentët që refuzojnë notën, pyetësi në listën – raportin e tij shënon “abstenon”.

d) Refuzimi i notës mund të bëhet brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i komunikimit të rezultateve, pas kalimit të këtij nuk mund të refuzohet nota.

e) Studenti është i obliguar që refuzimin e notës ta bëjë tek profesori i lëndës ose referenti përkatës dhe atë brenda afatit të paraparë në paragrafin e mësipërm.

f) Nota e përshkruar në raportin përfundimtar që dorëzohet në administratë, nuk mund të refuzohet dhe paraqet notën përfundimtare.

#### Neni 10

Në datën e përcaktuar për dhënien e notave, përveç profesorit, e obligueshme është edhe pjesëmarrja e studentit.

Profesori nuk mund të vendosë notën në evidencën e studentit-indeks pa prezencën e studentit.

#### Neni 11

a) Studenti i pakënaqur me vlerësimin e profesorit, brenda 24 orëve nga komunikimi i notës pas konsultimit me profesorin e lëndës mund të



ushtrojë ankesë më shkrim dekanatit të fakultetit përkatës përmes Shefit të Shërbimit të Studentëve. Ankesa duhet të jetë e arsyetuar.

b) Kryetarin dhe dy anëtarë të komisionit i emëron Dekani në afat prej 24 orësh nga marrja e ankesës, nëse e vlerëson se ankesa është e bazuar.

c) Njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë nga lënda tjetër e ngjashme, ndërsa pyetësi me notën e të cilit studenti nuk ka qenë i kënaqur nuk mund të jetë kryetar komisioni dhe nuk përcaktohet detyrimisht që ky të jetë anëtarë i komisionit.

d) Dekani e cakton kohën e mbajtjes së provimit në afat prej tri ditësh nga paraqitja e kërkesës së studentit.

e) Komisioni merr vendim me shumicë votash.

f) Vendimi i komisionit paraqet akt përfundimtar kundër të cilit nuk mund të ushtrohet ndonjë mjet juridik.

#### Neni 12

Studenti që nuk paraqitet në momentin e dhënies së notave, humb të drejtën e përcaktuar në nenin e mësipërm, mirëpo ai notën e arritur në provim mund ta marrë në një kohë, në bazë të marrëveshjes së arritur me profesorin e lëndës.

#### Neni 13

Profesori detyrohet që në administratë të dorëzojë raportin origjinal të vërtetuar me nënshkrimin e tij, ndërsa tek ai mbetet kopja e të njëjtit.

#### Neni 14

a) Provimi nga e njëjta lëndë mund të përsëritet më së shumti tri (3) herë. Studenti i cili edhe herën e tretë nuk e kryen provimin, herën e katërt provimit do t'i nënshtrohet para komisionit të themeluar nga dekanati i fakultetit përkatës.

b) Nëse studenti nuk e kalon provimin edhe herën e katërt, ai humb vitin akademik.

c) Nëse studenti edhe pas regjistrimit të lëndës nuk e kryen provimin në mënyrën e përcaktuar në alinenë b) të këtij neni, ai humb të drejtën e studimit në Universitet.



### Neni 15

Studenti fiton të drejtën për ta regjistruar vitin vijues nëse nga viti paraprak ka siguruar minimumin prej 16 pikëve (ECTS) nga dhënia e provimeve.

Në mesin e provimeve të kaluara duhet të jetë së paku një provim nga lëndët themelore.

Studenti fiton të drejtën për të ju nënshtruar provimeve të vitit pasardhës-vijues nëse nga viti paraprak ka siguruar minimumin prej 16 pikëve (ECTS) nga dhënia e provimeve dhe po ashtu ka përfunduar leksionet nga lënda përkatëse.

E drejta nga paragrafi i mësipërm nuk vlen për lëndët që janë të ndërlidhura dhe që nevojitet respektimi i kontinuitetit.

### Neni 16

a) Kontrolli i lëndëve profesionale (provim ose kontroll semestral) bëhet në forma specifike.

b) Kontrolli i dijës së një lënde (provimi) mund të bëhet:

- Me shkrim ose
- Me gojë
- I kombinuar, me shkrim e me gojë;

c) Mënyrat e kontrollit të dijës përcaktohen nga departamenti përkatës, mbështetur në planin mësimor.

d) Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës së bashku me asistentin e tij (aty ku ka) dhe miratohet e nënshkruhet nga përgjegjësi i departamentit ose i seksionit.

## II. KONTROLLI I DIJES

### Neni 17

a) Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur shlyen detyrimet vjetore që lidhen me atë lëndë, të parashikuara me planin mësimor.



b) Emrat e studentëve që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës paraqiten në fletën e provimit. Ajo nënshkruhet nga Dekani ose personi tjetër përgjegjës krahas nënshkrimit të sekretarisë dhe mban vulën e fakultetit. Me përfundimin e provimit, e njëjta dorëzohet në sekretari.

c) Në asnjë rast fleta e provimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.

d) Marrja në dorëzim e saj bëhet me nënshkrim (firmë).

#### Neni 18

Provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik, miratuar nga dekanati i fakultetit përkatës. Datat e tyre propozohen nga fakulteti – departamenti dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit.

#### Neni 19

Provimet janë publike dhe studenti ka të drejtë të kërkojë që publiku të jetë i pranishëm gjatë provimit.

#### Neni 20

a) Provimet zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Në rast pamundësie të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, Dekani, me urdhër me shkrim, e anulon atë dhe cakton një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve.

b) Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin edhe anëtarë të personelit universitar, me përjashtim të drejtuesit të departamentit, të fakultetit dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll.

#### Neni 21

Studenti, në sistemin me ose pa shkëputje nga puna, nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde, brenda një sesioni.



Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.

Studenti paraqitet në provim me dokument identifikimi me fotografi (indeks ose kartë identifikimi të Universitetit).

#### Neni 22

a) Studenti i vitit të fundit që, në përfundim të provimeve të kursit, rezulton në deri tri detyrime të pashlyera, ka të drejtë t'i shlyejë ato në një periudhë të caktuar nga Dekani para sesionit të provimit të diplomës.

b) Në çdo fund sesioni, Dekani shpall studentet përsëritës dhe ata të përjashtuar.

#### Neni 23

Studentët që lëvizin në kuadrin e projekteve e programeve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë Universiteti, nuk kanë nevojë të dëshmojnë pjesëmarrjen në procesin mësimor. Nëse studentët kanë dhënë provimet jashtë shtetit dhe në Universitete të tjera nga lëndët e ngjashme, atyre u njihen ato provime dhe nuk kanë nevojë të paraqiten në ato provime.

### **III. DIPLOMIMI**

#### Neni 24

Në përfundim të studimeve, studentët që diplomojnë, fitojnë titullin përkatës profesional nga lëmi që ka studiuar.

Kandidati i cili nuk arrin të diplomojë në sesionin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sesionin e ardhshëm.

Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën (me temë diplome ose provim formimi), pajiset me diplomë përkatëse.

Diploma plotësohet me shkrim, çart e më ngjyra teknike dhe nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit të provimeve të formimit, Rektori,



dhe Dekani. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit AAB.

#### Neni 25

Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, me nënshkrim dhe evidentohet në regjistrin përkatës.

Nëse prania e të diplomuarit është e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë një nga pjesëtarët e familjes, duke treguar dokumentin e identifikimit ose ndonjë person i autorizuar me shkrim.

#### Neni 26

Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet, duke iu bërë e papërdorshme, Universiteti nuk lëshon diplomë dublikate. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetimi me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga Rektori, Dekani dhe Sekretari i fakultetit dhe vulozet me vulën e Universitetit AAB.

#### Neni 27

Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni, në të cilën marrin pjesë autoritetet e Universitetit dhe të fakultetit përkatës.

### **IV. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTIT DHE MËSIMDHËNËSIT**

#### Neni 28

Studenti ka të drejtë:

- a) të marrë pjesë në ligjërata, seminare dhe aktivitete të tjera mësimore;
- b) të përdorë të gjitha instalimet dhe pajisjet e Universitetit, sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor e artistik;



- c) të përdorë bibliotekën – fonotekën, laboratorin kriminalistik dhe mjetet artistike e sportive të Universitetit;
- d) të përfaqësohet në Senatin e Universitetit në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse;
- e) të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse;
- f) të ushtrojë të drejtën e tij për ankesë lidhur me procesin e mësimdhënies ose lidhur me lokalet ku mbahet mësimi.

#### Neni 29

Studenti me të përfunduar studimet ka të drejtë të bëjë përmirësimin e më së shumti dy notave.

Studenti duhet t'i parashtojë kërkesë dekanatit të fakultetit përkatës për përmirësim e notës, kërkesa duhet të jetë e arsyetuar.

Pas aprovimit të kërkesës, studenti në afatin e rregullt vijues, mund t'i nënshtrohet provimit për ngritjen e notës nga lënda përkatëse.

Për përmirësim note studenti provohet vetëm një herë dhe mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund.

#### Neni 30

Studenti me notë mesatare 8.5 e sipër, i lejohet të hyjë në provime të vitit vijues edhe pa dëgjuar ligjëratat.

Studenti që dëshiron të shfrytëzojë të drejtën nga alineja 1 e këtij neni, duhet të paraqesë kërkesë pranë dekanatit të fakultetit përkatës dhe të njëjtës t'ia bashkëngjisë certifikatën e notave, si dëshmi për provimet e kryera dhe për mesataren e kërkuar.

#### Neni 31

Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa paraqitet në dekanat brenda 24 orëve nga momenti i përfundimit të provimit.



Dekani i fakultetit, pasi verifikon shkeljet e reklamuar me përgjegjësin e departamentit dhe me komisionin e provimit, merr vendim të formës së prerë.

Në rast se ankesa është e drejtë, Dekani vendos anulimin e provimit dhe urdhëron përsëritjen e tij në një datë të veçantë, jo më vonë se tri ditë nga përfundimi i sesionit të provimeve. Vendimi bëhet i njohur brenda pesë ditësh nga dita e ankesës.

### Neni 32

Studenti është i detyruar:

- a) t'i njohë në hollësi rregullat e Universitetit – fakultetit dhe detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për respektimin e tyre, në të kundërtën Universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat e mundshme si rezultat i mosnjohjes së tyre;
- b) t'i njohë dhe t'i zbatojë me përpikëri rregullat e mësimit dhe detyrimet e tij;
- c) t'i shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara me planin mësimor dhe programet e lëndëve;
- d) t'i respektojë të drejtat e personelit të Universitetit dhe të studentëve të tjerë;
- e) të ruajë prestigjin dhe dinjitetin e Universitetit.

### Neni 33

a) Shkelje të rregullave të Universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cenojnë personalitetin e mësimdhënësit dhe të çdo punonjësi tjetër të Universitetit, normat etiko – morale, si: kopjime në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme, aktet jomorale, vjedhja etj. Kur këto veprime nuk bartin elemente të veprës penale.

b) Ndaj studentit që kryen këto veprime, do të iniciohet procedura disiplinore në bazë të rregullores mbi procedurën disiplinore.

c) Masa më e lehtë disiplinore është vërejtja, kurse masa më e rëndë është përjashtimi i përhershëm nga Universiteti.



Neni 34

Të drejtat dhe detyrimet e mësimdhënësit përcaktohen me kodin e punës dhe me kontratat kolektive dhe individuale të tij.

Neni 35

- a) Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota universitare është deri në dyfishin e afatit të rregullt.
- b) Studentët që nuk arrijnë të përfundojnë studimet brenda këtij afati, humbasin të drejtën e vazhdimit të studimeve.
- c) Të drejtën e vazhdimit të studimeve e humbasin edhe studentët të cilët shpallën përsëritës të të njëjtit vit akademik dy herë.
- d) Afati maksimal për mbrojtjen e temës së diplomës është deri në tri vjet nga koha e përfundimit të studimeve.

**V. DISPOZITAT KALIMTARE**

Neni 36

Në rast se dispozitat e kësaj Rregulloreje bien në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Universitetit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

Neni 37

Rregullorja e Universitetit mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të saj.

Neni 38

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën e miratimit të saj nga Bordi i Universitetit AAB.

Prishtinë, 2006

\_\_\_\_\_  
Kryetari i Bordit të Universitetit